



## Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Nr/Br. 952120  
Datë/Datum. 07.12.20

PRISHTINË - PRISTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.952/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të: Blerim Dina - Kryetar, panelist individual, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “Pro ACC Group” SH.P.K-Prishtinë, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Vlerësimi i aseteve të Trainkos SH.A” me nr. të prokurimit: 10908-20-4910-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- Trainkos SH.A, më datën: 07.12.2020, mori këtë:

### V E N D I M

I. **APROVOHET**, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Pro ACC Group”SH.P.K-Prishtinë, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Vlerësimi i aseteve të Trainkos SH.A” me nr. të prokurimit: 10908-20-4910-2-2-1, iniciuar nga AK- Trainkos SH.A.

II. **VËRTETOHET**, njoftimi për anulim AK-së për aktivitetin e prokurimit me titull “Vlerësimi i aseteve të Trainkos SH.A” me nr. të prokurimit: 10908-20-4910-2-2-1, iniciuar nga AK- Trainkos SH.A.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "Pro ACC Group" SH.P.K-Prishtinë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

### ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues "Pro ACC Group" SH.P.K-Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 16.11.2020 me nr. 952/20, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Vlerësimi i asetëve të Trainkos SH.A" me nr. të prokurimit: 10908-20-4910-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- "Trainkos SH.A", duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 dhe nenin 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konfirmon nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 20.11.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 30.11.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në Pretendimet ankimore:

Eksperti Shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor 1 dhe 2 është i pabazuar ndërsa pretendim nr. 3 i bazuar për arsye se: Tek kërkesat mbi mundësit teknike dhe profesionale (pretendimi nr. 1 ) është kërkuar që Operatori Ekonomik duhet te caktojë një Menaxher të Projektit i cili duhet te jetë ekonomist i diplomuar në fushën e kontabilitetit apo financave dhe përvojë profesionale prej 10 viteve pas diplomimit në fushën e financave , bankave dhe kontabilitetit dhe kjo të dëshmohet me kopje të diplomës dhe CV, dhe për këtë kërkesë të Kualifikimit OE ankues nuk ofron dëshmi 10 vjeçare sepse menaxheri i projektit (Arian Shala) ofron diplomë për Baçeler i diplomuar në vitin 2008, ndërsa gradën



mastar drejtimi banka financa dhe kontabilitet e ka përfunduar ne vitin 2014 që do të thotë se një kërkesë e tillë nuk është përmbushur. Tek pika tre (3) e kapacitetit teknik dhe profesional është kërkuar një asistent i menaxherit të projektit i cili duhet të jetë i diplomuar në fushën e financave apo kontabilitetit me përvojë profesionale prej 5 viteve dhe duhet të jetë anëtar i ndonjë organizate të licencuar për kontabilitet publik. Sipas dëshmimeve asistenti i projekt menaxherit posedon diplomë se ke përfunduar fakultetin ekonomik por jo drejtimi banka dhe financa por drejtimi ekonomika e OPB-së qe do te thotë se kualifikimin qe posedon asistenti i projekt menaxherit nuk është ne përputhje me kërkesat e dosjes, ndërsa sa i përket vlerësimit të AK-së se asistenti i projekt menaxherit nuk është anëtar i ndonjë shoqate për kontabilitet publik nuk qëndron pasi që dëshmitë flasin se asistenti i Menaxherit të Projektit z Emin Sylejmani është anëtar i Shoqatës së kontabilisteve dhe Auditorve të certifikuar dhe njëkohësisht është i certifikuar si kontabilist.

#### Pretendimi ankimor nr. 3

I parashtruar nga OE ankues është i bazuar për faktin se OE Ankues ofron dëshmi dhe referenca të mjaftueshme dhe në përputhje me kërkesat e dosje së tenderit Sipas kërkesave kualifikuese Operatori Ekonomik duhet të dorëzojë se paku dy referenca dhe raporte të vlerësimit për vlerësim të aseteve në kompani të mëdha me vlere të aseteve minimum 3 milion Euro si dhe Operatori Ekonomik duhet të dorëzojë se paku 2 referenca dhe raporte të vlerësimit për vlerësim të aseteve të kompanive të mëdha me qarkullim jo me pak se 7.5 milion në tri vitet e fundit. Ne listën e kontratave të realizuara OE ankues ofron dëshmi se ka realizuar kontrata për vlerësim të pasurive të paluajtshme me banka të ndryshme ne Kosovë siç është banka BKT, TEB, Raiffesen Bank , KEP etj pastaj ofron dëshmi se ka bërë vlerësim të aseteve në KRU Prishtina dhe qarkullim i kësaj Ndërmarrje Publike në vitin 2019 ka qenë mbi 17 milion dhe ndërmarrja ka vlerë të aseteve mbi 110 milion Euro, pastaj OE ankues ka bërë vlerësim të aseteve në KRU "Gjakova" e cila sipas raporteve të vlerësimit ka vlerë të aseteve mbi 43 milion Euro dhe qarkullim mbi 5 milion euro. Lidhur me këtë kërkesë OE ankues ofron edhe raporte të vlerësimit për bankat dhe vlere të aseteve dhe vlere të qarkullimi kalon shumëfish vlerën e kërkuar . Si dëshmi është lista e kontratave të realizuara ku për pjesën me të madhe të kontratave të realizuar OE ankues ofron edhe referenca të cilat lehtësisht janë të verifikueshme pas qe tek lista e kontratave të realizuara janë cekur edhe personat kontaktues përmes se cilëve mund të verifikohen kontratat e realizuara.

#### Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar ne vlerësimet e cekura Eksperti Shqyrtues i rekomandon Panelit Shqyrtues qe te mbet ne fuqi vendimi i AK-së Pasi qe dy nga tri pretendimet janë te pa bazuara.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 30.11.2020 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 01.12.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik: "Pro ACC Group"SH.P.K - Prishtinë, me datë: 29.11.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Të nderuar,

Paraprkisht faleminderit për emailin tuaj, ju lutem nuk pajtohem me mendimin e ekspertit nr. 952/20, i dt:30.11.2020 kërkojmë nga paneli shqyrtues te rishqyrtoj kërkesën tonë duke marr parasysh që: Tek pika 1. Menaxheri i Projektit - Sa i përket kriterit ekonomist i Diplomuar ne drejtimin Banka Financa dhe Kontabilitet, personi ne fjale z. Arian Shala ka te përfunduar Master ne fakultetin ekonomik ne drejtimin Banka Financa dhe Kontabilitet dhe i njëjti ka 10 vite eksperience pune gjë qe plotëson kriterin e kërkuar plotësisht ndërsa, Tek pika 2. Sa i përket Pikës Asistent i Projektit - personi ne fjalë z. Emin Sylejmani ka diplomuar ne sistemin e para Bolonjës ne vitin 1989 ne Fakultetin ekonomik dhe ka marr titullin ekonomist i diplomuar (sistemi 4 vjeçar i studimit) ne at kohe nuk ka pasur dege te ndara i njëjti ka eksperience me shume se 30 vite ne fushën e financave, dhe i njëjti është Kontabilist i certifikuar nga SCAAK.

Ne si operator Ekonomik po ndihemi te diskriminuar, ku pretendent ne këtë aktivitet prokurimi jemi vetëm ne si OE dhe nuk ka ndonjë Kompani tjetër gjithashtu edhe me çmim jemi ofertuesit me te lire se te gjithë Operatorete tjerë. Kërkojmë nga ana e panelit shqyrtues te rishqyrtoj edhe njëherë mendimin e ekspertit shqyrtues me numër 952/20 dhe kërkesën tone ne lidhje me këtë aktivitet prokurimi: "Rivlerësimi i Aseteve te Trainkos". nr. i prokurimit: 10908-20-4910-2-2-1 nr. brendshëm: TRKOS/20/52/221. Shpresojmë qe kërkesa jone te aprovohet, paraprkisht kërkojmë mirëkuptim nga ana juaj, me respekt,

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 07.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.



Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK tek kërkesat mbi mundësit teknike dhe profesionale (pretendimi nr. 1 ) është kërkuar që Operatori Ekonomik duhet te caktojë një Menaxher të Projektit i cili duhet te jetë ekonomist i diplomuar në fushën e kontabilitetit apo financave dhe përvojë profesionale prej 10 viteve pas diplomimit në fushën e financave, bankave dhe kontabilitetit dhe kjo të dëshmohet me kopje të diplomës dhe CV, dhe për këtë kërkesë të Kualifikimit OE ankues nuk ofron dëshmi 10 vjeçare sepse menaxheri i projektit (Arian Shala) ofron diplomë për Baçoler i diplomuar në vitin 2008, ndërsa gradën mastar drejtimi banka financa dhe kontabilitet e ka përfunduar në vitin 2014 që do të thotë se një kërkesë e tillë nuk është përmbushur.

Tek pika tre (3) e kapacitetit teknik dhe profesional është kërkuar një asistent i menaxherit të projektit i cili duhet te jetë i diplomuar në fushën e financave apo kontabilitetit me përvojë profesionale prej 5 viteve dhe duhet të jetë anëtar i ndonjë organizate të licencuar për kontabilitet publik. Sipas dëshmimeve asistenti i projekt menaxherit posedon diplomë se ke përfunduar fakultetin ekonomik por jo drejtimi banka dhe financa por drejtimi ekonomika e OPB-së që do të thotë se kualifikimin që posedon asistenti i projekt menaxherit nuk është në përputhje me kërkesat e dosjes, ndërsa sa i përket vlerësimit të AK-së se asistenti i projekt menaxherit nuk është anëtar i ndonjë shoqate për kontabilitet publik nuk qëndron pasi që dëshmitë flasin se asistenti i Menaxherit të Projektit z Emin Sylejmani është anëtar i Shoqatës së kontabilistëve dhe Auditorve të certifikuar dhe njëkohësisht është i certifikuar si kontabilist.

Sa i përket pretendimit tjetër të OE ankues, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se ky pretendim është i bazuar për faktin se OE Ankues ofron dëshmi dhe referenca të mjaftueshme dhe në përputhje me kërkesat e dosje së tenderit. Sipas kërkesave kualifikuese, Operatori Ekonomik duhet te dorëzojë se paku dy referenca dhe raporte të vlerësimit për vlerësim të aseteve në kompani të mëdha me vlere të aseteve minimum 3 milion Euro si dhe Operatori Ekonomik duhet te dorëzojë se paku 2 referenca dhe raporte të vlerësimit për vlerësim të aseteve të kompanive të mëdha me qarkullim jo me pak se 7.5 milion në tri vitet e fundit. Në listën e kontratave të realizuara të OE ankues, ofron dëshmi se ka realizuar kontrata për vlerësim të pasurive të paluajtshme me banka të ndryshme në Kosovë siç është banka BKT, TEB, Raiffesen Bank , KEP etj pastaj ofron dëshmi se ka bërë vlerësim të aseteve në KRU Prishtina dhe qarkullim i kësaj Ndërmarrje Publike në vitin 2019 ka qenë mbi 17 milion dhe ndërmarrja ka vlerë të aseteve mbi 110 milion Euro, pastaj OE ankues ka bërë vlerësim të aseteve në KRU “Gjakova” e cila sipas raporteve të vlerësimit ka vlerë të aseteve mbi 43 milion Euro dhe qarkullim mbi 5 milion euro. Lidhur me këtë kërkesë OE ankues ofron edhe raporte të vlerësimit për bankat dhe vlera e aseteve dhe vlera e qarkullimi kalon shumëfish vlerën e kërkuar . Si dëshmi është

lista e kontratave të realizuara ku për pjesën me të madhe të kontratave të realizuar OE ankues ofron edhe referenca të cilat lehtësisht janë të verifikueshme pas që tek lista e kontratave të realizuara janë cekur edhe personat kontaktues përmes se cilëve mund të verifikohen kontratat e realizuara.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim se pretendimi i OE ankues në lidhje me projekt menaxherin dhe asistentin e projekt menaxherit janë të pa bazuara, që rezulton se AK e ka anuluar këtë aktivitet të prokurimit në harmoni me nenin 62 të LPP-së sepse tenderi i OE ankues është i pa përgjegjshëm dhe në kundërshtim me kriteret e dosjes së tenderit.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

#### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.



#### **Vendimi t'i dorëzohet:**

- 1x1 AK "Trainkos S.H.A";
- 1x1 OE "Pro ACC Group" S.H.P.K –Prishtinë;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.